



Nr. Ref. BD-195/1

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelës Nr. 93-21, me sipërfaqe të përgjithshme 275 m², Zona Kadastrale Hani i Elezit, pronë e PMN "Sharr" me parashtruesin nga Hani i Elezit.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin rekomandohet aprovimi i iniciimit të procedurës për shitje direkte të parcelës Nr. 93-21, me sipërfaqe të përgjithshme 275 m², Zona Kadastrale Hani i Elezit, pronë e PMN "Sharr" me parashtruesin , nga Hani i Elezit.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.


Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë, dhe duke qenë se rasti i plotëson kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 3, paragrafi 1.2 për palën , të Rregullores Nr. 16/2023, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 janar 2024




Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-195/2

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale nr. P-70705076-00506-5 sipërfaqja e përgjithshme: 7,056 m², pronë e Ndërmarrjes Shoqërore "Agimi" Gjakovë, me parashtruesin fshati Xërxë, Komuna e Rahovecit.
- I. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale nr. P-70705076-00506-5 sipërfaqja e përgjithshme: 7,056 m², pronë e Ndërmarrjes Shoqërore "Agimi" Gjakovë, me parashtruesin fshati Xërxë.


Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.


Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 3 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e vet e kanë bazuar vetëm mbi faktin se prona parcela kadastrale P-70705000506-5, që nga viti 2000 e ka në posedim faktik të cilën edhe e ka rrethuar. Pala deklaroi se ai është i vetëdijshëm se prona lëndore është në pronësi të NSH-së dhe se menaxhohet nga AKP, mirëpo sipas palës kjo pronë i përmbush interesa e tij si investitor i mundshëm në bujqësi e me theks të veçantë lulishte pasi që edhe me profesion është kopshtarë prandaj edhe planifikon investim familjar në këtë paluajtshmëri. Gjithashtu prona ka një shtrirje dhe qasje direkte në rrugë publike, pozicion të përshtatshëm, transformimi përmes tenderimit publik është zgjidhje e duhur gjasa më të mëdha për një vlerë më të madhe në dobi të NSH-së. Njëherësh prona lëndore me këtë sipërfaqe mund të jetë e rëndësishme për interes publik. Posedimi i pronës të NSH-së nuk është bazë e mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 janar 2024




Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-195/3

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale nr P-70705076-00506-7 sipërfaqja e përgjithshme: 10284 m², pronë e Ndërmarrjes Shoqërore "Agimi" Gjakovë, me parashtruesin fshati Xërxë, Komuna e Rahovecit.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale nr P-70705076-00506-7 sipërfaqja e përgjithshme: 10284 m², pronë e Ndërmarrjes Shoqërore "Agimi" Gjakovë, me parashtruesin fshati Xërxë, Komuna e Rahovecit.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se pala nuk ka siguruar dokumentacionin e nevojshëm për asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 3 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e vet e kanë bazuar vetëm mbi faktin se parcela kadastrale lëndore sipas regjistrit kadastral Ndërmarrja Shoqërore është në bashkëpronësi me 8 persona private dhe të cilët janë në bashkëpronësi me nga 1/26 apo 400 m², ndërsa NSh-ja është pronare e 7119 m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 10284 m². Sipas deklaratës së parashtruesit të kërkesës z. , pjesët nga bashkëpronësia e personave privat i ka blerë.

Megjithatë në shkresat e lëndës nuk ka dëshmi për fitimin e pronësisë nga parashtruesi i kërkesës, përveç disa autorizime e që disa prej tyre janë të palexueshme. Gjithashtu sipas shkresave të lëndës, certifikatës e pronësisë dhe ekspertizës kadastrale nuk figuron që z. ka të regjistruara të drejta pronësore. Sipas parashtruesit i vetëdijshëm se prona lëndore është në pronësi të NSh-së dhe se menaxhohet nga AKP, mirëpo sipas palës kjo pronë i përmbush interesa e tij si investitor i mundshëm në bujqësi e me theks të veçantë lulishte pasi që edhe me profesion është kopshtarë prandaj edhe planifikon investim familjar në këtë paluajtshmëri.

Agjencia konsideron se sipërfaqja e kërkuar nga pala është e madhe dhe si e tillë ngastra i plotëson kriteret të jetë pjesë e transfereve pronësore që do ti barten Ministrisë së Bujqësisë ,bazaur në strategjinë përmbyllëse të Agjencisë.

Parcela kadastrale e cila është në bashkëpronësi me Ndërmarrjen Shoqërore gjendet në zonën kadastrale në periferi të qytetit të Gjakovës dhe ka një pozitë shumë të përshtatshme për të gjitha veprimtarit. Prona ka qasje të pa penguar në rrugë publike dhe aktualisht nuk ka ndërtim.

Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


MA



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 15 janar 2024



Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-195/4

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të pjesës të parcelës me sipërfaqe prej 4279 m² nga totali i përgjithshëm 8859 m² parcela kadastrale nr. 04612-0; si dhe të pjesës të parcelës me sipërfaqe prej 6521 m² nga totali i përgjithshëm 14357 m² parcela kadastrale nr. 04614-1, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore "Ereniku" Prodhimtaria Primare, Zona Kadastrale Jashtë qytetit Gjakovë, me parashtruesin _____ nga Gjakova.
- I. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pjesës të parcelës me sipërfaqe prej 4279 m² nga totali i përgjithshëm 8859 m² parcela kadastrale nr. 04612-0; si dhe të pjesës të parcelës me sipërfaqe prej 6521 m² nga totali i përgjithshëm 14357 m² parcela kadastrale nr. 04614-1, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore "Ereniku" Prodhimtaria Primare, Zona Kadastrale Jashtë qytetit Gjakovë, me parashtruesin _____ nga Gjakova.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 3 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e vet e ka bazuar vetëm mbi faktin se thekson se ai është pronar i parcelës kadastrale nr P-70705028-00089K-0, e cila kufizohet me parcelat 04612-0 dhe 04614-1, të cilat janë në pronësi të NSH "Ereniku" Prodhimtaria Primare Gjakovë. Bazuar në deklaratën se palës se ai gjatë rilevimit të bërë në vitin 2019, ka pas të ndërtuar objektin prej 58 m², në parcelën 04612-0, objektin prej 40m² dhe 49 m² të ndërtuara në parcelën 04614-1. Pala thekson se për ndërtimin e këtyre objekteve ka investuar shumë mjete financiare në të cilën ka vendos edhe rrethoje me telë. Gjithmonë sipas deklaratës së palës, ndërtimet janë bërë pa dijeni se prona në të cilat po ndërton janë prona të ndërmarrjes shoqërore.

Gjatë analizimit të shkresave të lëndës dhe informatave të siguruar nga ZR Pejë, është konstatuar se ndërtimet janë bërë nga pala afërsisht në muajin tetor 2019. Dhe se kjo bie ndesh me kriteret ligjore për shitje direkte sipas Rregullores 16/2023 ku prerja bëhet për ndërtimet deri më 31.12.2018. Parcelat kanë qasje në rrugë, dhe se ndërtimet e bëra nuk mund të kenë ndonjë impakt, nuk janë të destinimit për banim dhe se nuk kanë ndonjë sipërfaqe e cila proporcionalisht do të duhet të trajtohet mundësia e ndarjes apo parcelimi të pronave të NSH-së. Pas trajtimit të shkresave të lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

MH




AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 janar 2024



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-195/5

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelave kadastrale: nr. P-70705071-00102-0 sipërfaqja e përgjithshme: 7160 m² dhe nr. P-70705071-00102-0 sipërfaqja e përgjithshme 15540 m², pronë e Ndërmarrjes Shoqërore "Ereniku" Gjakovë, me parashtruesin _____ nga fshati Novosellë e Poshtme, Komuna e Gjakovë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të parcelave kadastrale: nr. P-70705071-00102-0 sipërfaqja e përgjithshme: 7160 m² dhe nr. P-70705071-00102-0 sipërfaqja e përgjithshme 15540 m², pronë e Ndërmarrjes Shoqërore "Ereniku" Gjakovë, me parashtruesin _____ nga fshati Novosellë e Poshtme, Komuna Gjakovë.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 3 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e vet e kanë bazuar vetëm mbi faktin se parcelat në fjalë kohë më parë kanë qenë pronë e tyre të cilat ju janë shitur familjes _____ nga Gjakova ndërsa familja _____ ia shet KBI "Ereniku" për themelimin e kompleksit bujqësorë. Sipas deklaratës së palës KBI Ereniku nuk e kishte formuar asnjëherë kompleksin bujqësorë. Pronat në fjalë i ka në posedim dhe i shfrytëzon parashtruesi i kërkesës. Në pronë nuk ka të ndërtuar asgjë dhe se te dy parcelat kanë qasje në rrugën publike që përshkon – fshatin Novosellë e Poshtme. Është me rëndësi se vetë pala deklaron se paraardhësi i tyre me vullnetin e lirë e kishte shitur këtë pronë dhe është në dijeni se prona i takon NSh-së. Posedimi i pronës të NSh-së tash e një kohë të gjatë nuk është bazë e mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 janar 2024



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-195/6

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelave kadastrale: P-70705037-01227-0 me sipërfaqe prej 135822 m²; P-70705037-01228-0 me sipërfaqe prej 26244 m²; P-70705037-01229-0 me sipërfaqe prej 28904 m²; P-70705037-01230-0 me sipërfaqe prej 16663 m²; P-70705037-01231-0 me sipërfaqe prej 22264 m²; P-70705037-01232-0 me sipërfaqe prej 45127 m². Zona Kadastrale Jahoc, Komuna e Gjakovës, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore KB "Ereniku" Gjakovë me parashtruesin _____ nga fshati Jahoc, Komuna Gjakovë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të parcelave kadastrale: P-70705037-01227-0 me sipërfaqe prej 135822 m²; P-70705037-01228-0 me sipërfaqe prej 26244 m²; P-70705037-01229-0 me sipërfaqe prej 28904 m²; P-70705037-01230-0 me sipërfaqe prej 16663 m²; P-70705037-01231-0 me sipërfaqe prej 22264 m²; P-70705037-01232-0 me sipërfaqe prej 45127 m². Zona Kadastrale Jahoc, Komuna e Gjakovës, pronë e NSH KB "Ereniku" Gjakovë me parashtruesin _____ nga fshati Jahoc, Komuna Gjakovë.


Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore. Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 3 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesës e vet e kanë bazuar vetëm mbi faktin se parcelat në fjalë i shfrytëzojnë qysh nga viti 1990 pa u penguar askush dhe se ai së bashku me familjen e tij është kujdesur në mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e këtyre pronave. Prona janë me kulturë mal dhe kullosa dhe se sipas deklaratës së parashtruesit të kërkesës ata e kanë mbrojtë nga prerja ilegale e drunjëve apo shfrytëzimi i pa autorizuar i kullosave. Parcelat kadastrale janë të lira nga ndërtimet, kanë qasje në rrugë publike, dhe se nuk bien në kategorinë për shitje direkte. Posedimi i pronës të NSH-së tash e një kohë të gjatë nuk është bazë e mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 janar 2024




Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-195/7

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale nr. 01092-0 në sipërfaqe prej 16883 m², pronë e Ndërmarrjes Shoqërore "Bec" Gjakovë, me parashtruesin nga fshati Bec, Komuna Gjakovë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale nr. 01092-0 në sipërfaqe prej 16883 m², pronë e NSh "Bec" Gjakovë, me parashtruesin nga fshati Bec, Komuna Gjakovë.


Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.


Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 3 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e vet e kanë bazuar vetëm mbi faktin se parcelën në fjalë P-70705005-01092-0 e posedon që nga viti 1999 ndersa ne vitin 2017 ka lidh kontratë qiraje me AKP-në. Pala thekson me që kjo pronë nuk është tenderuar dhe kërkon që këtë pronë ta blej përmes shitjes direkte. Parcela kadastrale ka një pozicion me qasje në rrugë, nuk ka të ndërtuar asgjë e as ndonjë infrastrukturë përcjellëse në pronë. Pavarësisht deklarimit të palës se ai që nga viti 1999, e ka në posedim këtë parcel, nuk mund të ketë kurrfarë ndikim në merita të kërkesës. Posedimi i pronës të NSh-së që nga vitit 1999 nuk është bazë e mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 janar 2024




Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400

Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org

ee.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



Nr. Ref. BD-195/8

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të pjesës 50 m² të parcelës kadastrale nr. P-70705028-05490-1, sipërfaqja e përgjithshme: 3662 m², pronë e Ndërmarrjes Shoqërore "Ereniku" Gjakovë, me parashtruesin nga Gjakova.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pjesës 50 m² të parcelës kadastrale nr. P-70705028-05490-1, sipërfaqja e përgjithshme: 3662 m², pronë e Ndërmarrjes Shoqërore "Ereniku" Gjakovë, me parashtruesin nga Gjakova.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e vet e kanë bazuar vetëm mbi faktin se thekson se në parcelën lëndore në vitin 2013, ka ndërtuar objekt – lokal in afarist të cili sipas deklaratës së palës e kishte edhe më parë por ishte i karakterit të përkohshëm apo montazh i cili me kalimin e kohës ishte shkatërruar dhe nuk ishte e mundur të vazhdonte as kushte minimale për ushtrimin e aktivitetit ekonomik.


Agjencia konsideron se AKP si institucion publik te kategoritë e këtilla të ndërtimit ilegal në hapësira publike (trotuare) nuk do krijoj marrëdhënie juridike të shitblerje së pronës pasë parasysh dhe argumentin tjetër se parcela kadastrale ka një pozicion kompakt e cila gjendet në një pjesë shumë të rëndësishme të qytetit të Gjakovës dhe në mënyrën e tanishme është pengesë për qasje të lire në Spitalin e këtij qyteti dhe sipas të dhënave nga gjeoportali pjesa më e madhe e kësaj parcele në dukje ka destinim publik – rrugë publike prandaj ne mendojmë që kjo parcelë nëse jo për interes publik shitja me tender është adekuat Në rrethana të tilla shitja direkte dhe bartja eventuale e kësaj parcele në emër të palëve të treta me shitje direkte nuk është e përshtatshme apo e duhur. Shitja direkte me parashtruesin nuk është zgjidhja me e drejtë dhe më e dobishme për ti krijuar efektet pozitive në procesin e transformimit pronësor të këtij aseti.

Faktet e paraqitura nuk janë bazë e mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaqme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 janar 2024



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-195/9

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale nr. P-7100602-00711-2 në sipërfaqe prej 17,957 m², pronë e Ndërmarrjes Shoqërore "Malishgani" Klinë, me parashtruesin _____ nga Peja.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale nr. P-7100602-00711-2 në sipërfaqe prej 17,957 m², pronë e NSH "Malishgani" Klinë, me parashtruesin _____ nga Peja.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e vet e kanë bazuar vetëm mbi faktin se mendon se Nr. P-7100602-00711-2 në sipërfaqe prej 17,957 m², pronë e ndërmarrjes shoqërore "Malishgani" Klinë dhe menaxhohet nga AKP ishte në pronësi të gjyshit të tij _____ dhe se ai konsideron se i takon e drejta e parablerjes dhe së dyti kjo pronë kufizohet edhe me pronat e tij private dhe se qasja në këtë parcelë bëhet vetëm përmes pronave private. Parcela kadastrale ka një pozicion kompakt, nuk ka të ndërtuar asgjë e as ndonjë infrastrukturë përcjellëse në pronë.

Pala ka zhvilluar procedurën gjyqësore pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, me padi për vërtetim pronësie. Me aktgjykimin përfundimtarë të shkallës së dytë të DhPGJS Ref Nr. AC-I-13-0151, ju është refuzuar padia e paditësit _____ si e pa bazuar në ligj. Nuk ka asnjë procedurë tjetër gjyqësore.

Aktgjykim përfundimtar nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës është njëra nga bazat juridike e llojit të veçantë për refuzimin iniciimit të procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 janar 2024



Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-195/10

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale nr.P-70806036-00691-15, sipërfaqja e përgjithshme 312 m², pronë e Ndërmarrjes Shoqërore Banja e Pejës, me parashtruesin nga Banjë, Komuna Istog.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale nr.P-70806036-00691-15, sipërfaqja e përgjithshme 312 m², pronë e NSh Banja e Pejës, me parashtruesin nga Banjë, Komuna Istog .


Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore. Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë, Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 3 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e vet e kanë bazuar vetëm mbi faktin e plotësimit të formularit të kërkesës ku nuk ka shprehur deklaratën e tij se çka kërkon. Në mbështetje të formularit, pala ka ofruar ekspertizën gjeodezike, foto nga lokacioni i pronës dhe certifikatën pronësore të cilat evidentohen në emër të parashtruesit të kërkesës. Pavarësisht mos deklarimit të qartë të palës për pretendimet e tij për blerjen e kësaj prone me shitje direkte, nga shkresat e lëndës konstatohet se kërkesa e palës nuk e plotëson asnjë nga kriteret e përcaktuara me Rregullore Nr. 16/2023 për shitjen direkte.

Në parcelë nuk ka ndërtim përveç që është e rrethuar me tel të metali dhe parcela gjendet në një lokacion të mirë dhe ka qasje të pa penguar në rrugë publike. Nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë e mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 janar 2024



Mentor Hyseni

Kryesues

Bordi i Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-195/11

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale nr. P-70705028-04414-4, në sipërfaqe prej 800 m2, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore "Ereniku" Prodhimtaria Primare – Gjakovë, me parashtruesin _____ nga fshati Brekoc, Komuna Gjakovë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale nr. P-70705028-04414-4, në sipërfaqe prej 800 m2, pronë e NSh "Ereniku" Prodhimtaria Primare – Gjakovë, me parashtrues _____ nga fshati Brekoc, Komuna Gjakovë.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.


Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 3 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e vet e kanë bazuar vetëm mbi faktin se ai është pronar i disa parcelave tjera aty afër pronës lëndore. Pala në mbështetje të këtij pretendimi ka bashkangjitur certifikatën pronësore nga ku konstatohet se parcelat me nr 04414-3, 04414-6 dhe 4414-7, evidentohen në emrin e parashtruesit të kërkesës. Nga shikimi i gjendjes grafike bërë përmes Gjoportalit, konstatohet se parcela 4414-4 në pronësi të NSh-së, kufizohet me parcelat kadastrale 4414-2, 05801-0, 4454-0 si dhe 05845-0. Nga këto krahasime vërehet se pronat e parashtruesit të kërkesës nuk kufizohen me pronën e NSh-së. Parcela kadastrale ka një pozicion me qasje në rrugë, nuk ka të ndërtuar asgjë e as ndonjë infrastrukturë përcjellëse në pronë.

Nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë e mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 janar 2024



Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-195/12

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale nr P-70705076-00311-0 Sipërfaqja e përgjithshme: 342923 m², pronë e Ndërmarrjes Shoqërore "Ereniku" Gjakovë, me parashtruesin _____ nga Gjakova.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale nr P-70705076-00311-0 Sipërfaqja e përgjithshme: 342923 m², pronë e NSH "Ereniku" Gjakovë, me parashtrues _____ nga Gjakova.


Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.


Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë, Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 3 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e vet e kanë bazuar vetëm mbi faktin se kërkon që përmes shitjes direkte të blejë pjesë të parcelës 311, pa e specifikuar numrin e ngastrës kadastrale. Sipas deklaratës së parashtruesit të kërkesës, ai është pronar i parcelave kadastrale 177/5 dhe 135/5 e të cilat kufizohen me parcelën kadastrale nr 311, në pronësi të Nsh-së. Kërkesa e palës nuk është dorëzuar me të gjitha informata siç kërkohet në formularin e kërkesës, nuk ka dorëzuar ekspertizën gjeodezike për të përcaktuar saktë pjesën e pronës të cilën kërkon ta blejë. Megjithatë edhe po të dorëzohej ekspertiza, përsëri kërkesa e palës nuk i plotëson kriteret ligjore për shitje direkte. Parcela kadastrale ka një sipërfaqe të madhe, gjendet në një pozicion të përshtatshëm e cila i ka 38 ndarje me kultura të ndryshme dhe kufizohet me kanalin e ujitjes Radoniqi. Parcela ka qasje në rrugë, nuk ka të ndërtuar asgjë e as ndonjë infrastrukturë përcjellëse në pronë. Pavarësisht faktit se parashtruesi i kërkesës i ka edhe dy parcela tjera private që kufizohen me pronën e Nsh-së, nuk është bazë e mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 janar 2024




Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-195/13

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelave kadastrale: P-716111083-00508-1 me sipërfaqe prej 8690 m2 dhe P-716111083-00507-3 me sipërfaqe prej 842 m2. Zona Kadastrale Triboviq, Komuna e Pejës, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore KB "Kooperimi" Pejë, me parashtruesin nga Peja.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të parcelave kadastrale: P-716111083-00508-1 me sipërfaqe prej 8690 m2 dhe P-716111083-00507-3 me sipërfaqe prej 842 m2. Zona Kadastrale Triboviq, Komuna e Pejës, pronë e NSH KB "Kooperimi" Pejë, me parashtruesin nga Peja.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 3 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e vet e kanë bazuar vetëm mbi faktin se sipas tij parcelat lëndore ishin prona të paraardhësve të tyre të cilat ju ishin marr dhunshëm dhe ju janë shitur ndërmarrjes shoqërore. Pala thekson se përkundër faktit se një procedurë gjyqësore lidhur me padinë e tyre për vërtetim pronësie ende nuk ka përfunduar, kërkojnë që këto dy parcela të i shiten atyre përmes shitjes direkte. Pala gjithashtu thekson se në këto prona kanë bërë investime duke ndërtuar mini ferma për pula, instalimin e rrymës, ujit si dhe rrethojës në pronë.

Parcelat kadastrale kanë një pozicion me qasje në rrugë, ndërsa ndërtimet e bëra në këtë pronë nuk janë me destinim banimi e as nuk janë shumë domethënëse që rasti të kategorizohet për shitje direkte. Ndërsa sa i përket investimit në infrastrukturë për rrymë dhe ujë në rastin konkret janë të papërfillshme.

Agjencia ka parasysh edhe faktin se një procedurë gjyqësore e iniciuar nga pala është aktive por pas analizimit të shkresave të lëndës e edhe të dy vendimeve të DhPGJS, vërehet se pala nuk ka ndonjë titull të vlefshëm juridik i cili potencialisht mund të ketë epilog në favor të palës dhe se nuk mund të ketë kurrfarë ndikim në merita të kërkesës.


Nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë e mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 janar 2024




Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-195/14

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet inicimi i procedurës për shitje direkte të: parcelës me sipërfaqe prej 13230 m² nga totali i përgjithshëm 23550 m² parcela kadastrale Nr. 0447-0; parcelës me sipërfaqe prej 698 m² nga totali i përgjithshëm 721 m² parcela kadastrale Nr. 0448-0; parcelës me sipërfaqe prej 200 m² nga totali i përgjithshëm 361 m² parcela kadastrale Nr. 0449. Të gjitha në pronësi të Ndërmarrjes Shoqërore "Ereniku" Prodhimtaria Primare, Zona Kadastrale Qerim Komuna Gjakovë, me parashtruesin _____ nga Gjakova.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për inicim të procedurës për shitje direkte të parcelës me sipërfaqe prej 13230 m² nga totali i përgjithshëm 23550 m² parcela kadastrale Nr. 0447-0; parcelës me sipërfaqe prej 698 m² nga totali i përgjithshëm 721 m² parcela kadastrale Nr. 0448-0; parcelës me sipërfaqe prej 200 m² nga totali i përgjithshëm 361 m² parcela kadastrale Nr. 0449 - të gjitha në pronësi të NSH "Ereniku" Prodhimtaria Primare, ZK Qerim Komuna Gjakovë, me parashtruesin _____ nga Gjakova.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për inicim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 3 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e vet e kanë bazuar vetëm mbi faktin se thekson se ai që nga viti 1999, i ka në posedim dhe shfrytëzon këto prona në të cilën edhe ka ndërtuar shtëpi në të cilën jeton ai së bashku me familjen. Tutje pala deklaron se pronar ligjor i pronës lëndore është KBI Ereniku dhe administrohet nga ndërmarrja.

Të dhënat e paraqitura nga në ekspertizën e palës nuk përkojnë me të dhënat e Gjeoportalit. Në krahasimin e bërë për parcelën kadastrale të cilës pala i referohet me numrin e ngastrës 449-5, theksohet se kjo parcelë ka sipërfaqe të përgjithshme 361 m², ndërsa sipas të dhënave zyrtare të gjeoportalit parcela nr 449 nuk figuron që ka ndarje dhe ka një sipërfaqe prej 21424 m² dhe në një pjesë të caktuar të kësaj parcele kadastrale gjendet e ndërtuar një shtëpi ndërsa një pjesë është krijuar rrugë publike. Nga vizita në terren e zyrtarëve të Agjencisë është konstatuar se pala e mbanë në posedim parcelën kadastrale 447 në të cilën janë ndërtuar disa objekte të cilat nuk kanë destinim banimin. Poashtu konstatohet se pala me muri të betonit ka kufizuar qasjen e parcelave në rrugën kryesore publike. Ekspertiza e palës thekson se në pronë janë ndërtuar 5 objekte me karakter të përzier, banimi lokal afarist dhe bujqësi. Disa ndërtime janë bërë nga pala në pronën e cila kërkohet të blihet por nuk ka shtëpi banimi. Nga fotografit dhe ekspertiza gjeodezike shihet qartë se ekzistojnë objekte të cilat sipas evidencës kanë qenë edhe në të kaluarën.

MA



Megjithatë, parcelat kanë qasje në rrugë, dhe se ndërtimet eventuale të bëra përveç atyre ekzistuese, nuk mund të kenë ndonjë impakt, nuk janë të destinimit për banim dhe se nuk justifikojnë shitjen direkte të tri parcelave me shitje direkte.

Nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë e mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 janar 2024



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-195/15

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet përsëritja e vlerësimeve për dy rastet si më poshtë.
- II. Autorizohet Menaxhmenti i AKP-së që të inicioj procedurën për përsëritjen e vlerësimit për paluajtshmërit/asetet – ngastrat kadastrale në pronësi të NPB “Urata” apo PSH Ndërmarrja Tregtare Voqar në Prishtinë, ku palë është
- III. Autorizohet Menaxhmenti i AKP-së që të inicioj procedurën për përsëritjen e vlerësimit për asetet – ngastrat kadastrale në pronësi të PSH KBI “KOSOVA EXPORT” në Prishtinë, ku palë është
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Menaxhmenti dhe Divizioni për shitje direkte – Departamenti i realizimit të asetëve dhe shpërndarjes për dërgim për ekspertizë të raporteve të vlerësimit si në vijim: i) asetet – ngastrat kadastrale në pronësi të NPB “Urata” apo PSH Ndërmarrja Tregtare Voqar në Prishtinë; dhe ii) asetet – ngastrat kadastrale në pronësi të PSH KBI “KOSOVA EXPORT” në Prishtinë.

Gjatë viteve 2019, 2020 dhe 2021, Agjencia ka pranuar vlerësime për pronat të cilat kanë qenë të aprovuara nga Bordi i Drejtorëve që t’i nënshtrohen procesit të shitjes me negociim direkt, dhe për të cilat për shkak të rrethanave objektive duke përfshirë pandeminë globale si dhe për shkak të pezullimit të punës të NJND-së, raportet përfundimtare, pjesë e të cilave janë edhe vlerësimet nuk janë proceduar tutje në Bordin e Drejtorëve për vendosje përfundimtare. Aktualisht është 1 Raport i vlerësimit të shkallës së parë dhe 1 Raport i shkallës së dytë (i cili sipas bazës nënligjore të aplikueshme në fuqi kanë qenë vlerësime përfundimtare).

Si rrjedhojë e situatave të sipërcekura Agjencia është gjendur në situatë kur këto vlerësime mund të mos ta pasqyrojnë vlerën e drejtë të pronës meqenëse ka kaluar një kohë relativisht e gjatë nga vlerësimet e fundit, dhe bazuar në vlefshmërinë e raporteve vlerësuese ku sipas kriterëve të SEV është 12 muaj ndërsa vlerësimet e paraqitura datojnë se janë më të vjetra dhe rrjedhimisht është shfaqur nevoja për një vlerësim të ri i cili do të realizohet nga vlerësuesit e njëjtë, si dhe fakti i ndryshimeve të vlerës së asetëve nga periudha e vlerësimeve të para e deri tani kanë trende të rritjes, janë argumente për përsëritjen e procesit të vlerësimit. Duke marrë parasysh qëllimin e AKP-se për ruajtjen e vlerës të asetëve në pronësi shoqërore dhe të gjitha ato që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Duke marrë parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë, Bordit në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 16/2023 për



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh

Prishtinë, më 15 janar 2024



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-195/16

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet iniciimi i procedurës për shitje direkte për privatizimin të parcelës Nr. 657-0, me sipërfaqe të përgjithshme 37 m², Zona Kadastrale Gjakovë, pronë e të NSh "Agimi" me parashtruesen _____, nga Gjakova;
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin rekomandohet aprovimi i iniciimit të procedurës për shitje me negociim direkt të parcelës të parcelës Nr. 657-0, me sipërfaqe të përgjithshme 37 m², Zona Kadastrale Gjakovë, pronë e të NSh "Agimi" me parashtruesen _____, nga Gjakova.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.


Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë, dhe duke qenë Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti i plotëson kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 3, paragrafi 1.2 të Rregullores Nr. 16/2023, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 janar 2024.




Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-195/17

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 janar 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet iniciimi i procedurës për shitje direkte për privatizimin e sipërfaqes tokësore 554 m2 pjesë e Nr. P-71006024-00525-2 Sipërfaqe e përgjithshme 5610 m2 e cila evidentohet në emër të të NSH "Boksitet e Kosovës" Zona Kadastrale Klinë Komuna Klinë, me parashtruesin nga Klina
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin rekomandohet aprovimi i iniciimit të procedurës për shitje me negociim direkt për privatizimin e sipërfaqes tokësore 942 m2, pjesë e Nr. P-71006024-00525-2 Sipërfaqe e përgjithshme 554 m2 e cila evidentohet në emër të NSH "Boksitet e Kosovës" Zona Kadastrale Klinë Komuna Klinë, me parashtruesin nga Klina

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 16/2023 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë, dhe duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti i plotëson kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 3, paragrafi 1.1 dhe nenit 3, paragrafi 1.2 të Rregullores Nr. 16/2023, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 janar 2024



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit